

L I G J
Nr.7656, datë 12.1.1993

**PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.381, DATË 9.12.1992 "PËR
DISIPLINIMIN E LIKUIDIMIT TE VLEFTËS SË MALLRAVE E NDIHMAVE
SHTETËRORE USHQIMORE".**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 28 të ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Të miratohet dekreti nr.381, datë 9.12.1992 "Për disiplinimin e likuidimit të vleftës së mallrave të ndihmave shtetërore ushqimore" me këto ndryshime:

Titulli i dekretit të bëhet:

**DEKRET "PËR DISIPLINIMIN E LIKUIDIMIT TË VLEFTËS SË MALLRAVE TË
NDIHMAVE SHTETËRORE "**

Neni 1 të ndryshohet si vijon:

"Personat fizikë a juridikë privatë e shtetërorë që kanë marrë e do të marrin përsipër administrimin dhe shitjen e mallrave, të ndihmave shtetërore detyrohen të kryejnë në afatet e caktuara dokumentimin e likuidimit të vleftës së këtyre mallrave".

Neni 2 të ndryshohet si vijon:

"Ministria e Financave dhe Ekonomisë cakton afatet maksimale në marrëdhëniet midis ndërmarrjeve me njëra tjetrën si dhe midis tyre me buxhetin e shtetit për dokumentimin e likuidimit të vleftës së këtyre mallrave.

Në përputhje me këtë ndërmarrjet hartojnë marrëveshjet me njësitë e shitjes me pakicë për arkëtimin e detyrimeve".

Paragrafi i parë i nenit 4 të ndryshohet si vijon:

"Për shkeljet e afateve të caktuara personat përgjegjës dënohen për kundërvajtje administrative si vijon:

Paragrafi i katërt i nenit 4 të ndryshohet si vijon:

"Të drejtën e masës së denimit e kanë inspektorët e organeve të caktuara me ligj".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.427, datë 16.1.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha